



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, 24 dhe 40 të Ligjit, Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 27, 28 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe në zbatim të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-16-586, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren për ndryshim plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-110-47552, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

- 1.1 Me këtë vendim miratohet kërkesa 03-Nr-181-54736 e datës 16.09.2024 e parashtruar nga Shefket Kololli nga fshati Budakovë Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar në ndërtimin e shtëpisë, pasi që me datën 27.08.2024 i është djegur shtëpia. I ndahen mjete financiare në shumë prej: **5,000.00€ (pesë mijë euro)**.
- 1.2 Me këtë vendim miratohet kërkesa 03-Nr-820-55418 e datës 19.09.2024 e parashtruar nga Hajrush Destani nga fshati Delloc Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar në ndërtimin e shtëpisë pasi që me datën 15.09.2024 i është djegur shtëpia. I ndahen mjete financiare në shumë prej: **5,000.00€ (pesë mijë euro)**.
- 1.3 Me këtë vendim miratohet kërkesa 03-Nr-553-64198 e datës 18.11.2024 e parashtruar nga Nezir Loshi nga fshati Vraniq Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar në ndërtimin e shtëpisë pasi që me datën 10.11.2024 i është djegur shtëpia. I ndahen mjete financiare në shumë prej: **5,000.00€ (pesë mijë euro)**.

Neni 2

- 2.1 Mjetet financiare do të paguhen nga buxheti i Komunës së Suharekës të planifikuara në vitin 2025, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, kodi i programit 21/624/16012/22202/00000/0111 të planifikuar në Zyrën e Kryetarit (pagesa për transferet për përfitues individual të tjera).
- 2.2 Mjetet financiare do të lëshohen në xhirollogarinë e së cilit përfitues veç e veç.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës në bashkëpunim me Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI